

Përkthim jozyrtar i bërë nga Qendra Shqiptare për të Drejtën Ndërkombëtare (ACIL), mbështetur nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (Fondacioni IRZ).



ALBANIAN CENTER
OF
INTERNATIONAL LAW

DEUTSCHE STIFTUNG FÜR
INTERNATIONALE RECHTLICHE
ZUSAMMENARBEIT E.V.



Stabilitätspakt für Südosteuropa
Gefördert durch Deutschland
Stability Pact for South Eastern Europe
Sponsored by Germany

12.

KONVENTA MBI HEQJEN E KËRKESËS PËR LEGALIZIM TË DOKUMENTEVE ZYRTARE TË HUAJA *E miratuar më 5 tetor 1961*

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente,

Me dëshirën për të hequr kërkesën për legalizim diplomatik dhe konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja,

Vendosën të përfundojnë për këtë qëllim këtë Konventë duke rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

Neni 1

Kjo Konventë do të zbatohet për dokumentet zyrtare që ekzekutohen në territorin e një shteti kontraktues dhe duhet të lëshohen në territorin e një shteti tjetër kontraktues.

Për qëllimet e kësaj Konvente, sa më poshtë do të konsiderohen se janë dokumente publike:

a. dokumentet e lëshuara nga një autoritet ose funksionar i lidhur me gjyqësorin e shtetit, përfshirë edhe dokumentet e lëshuara nga një prokuror publik, një sekretar i një gjykate ose një përfaqësues që merret me njoftimet;

b. dokumentet administrative;

c. aktet noteriale;

d. vërtetimet zyrtare, të cilat janë vendosur mbi dokumentet e nënshkruara nga personat në cilësinë e tyre private, siç janë vërtetimet zyrtare që bëjnë regjistrimin e një dokumenti ose faktin që ai ka ekzistuar në një datë të caktuar, si dhe vërtetimet zyrtare e noteriale të nënshkrimeve.

Sidoqoftë, kjo Konventë nuk do të zbatohet:

a. për dokumentet e ekzekutuara nga agjentët diplomatikë ose konsullorë;

b. për dokumentet administrative që lidhen drejtpërdrejt me veprime tregtare ose doganore.

Neni 2

Çdo shtet palë do të përjashtojë nga legalizimi dokumentet e lëshuara në territorin e tij mbi të cilat zbatohet kjo Konventë. Për qëllimet e kësaj Konvente, legalizimi nënkupton vetëm formalitetin me anë të të cilit agjentët diplomatikë ose konsullorë të shtetit, në territorin e të cilit lëshohet dokumenti, vërtetojnë autenticitetin e nënshkrimit, cilësinë me të cilën ka vepruar personi që ka nënshkruar dokumentin dhe, nëse është rasti, identitetin e vulës dhe pullës që mban.

Neni 3

Me qëllim që të vërtetohet autenticiteti i nënshkrimit, cilësia në të cilën ka vepruar personi që firmos dokumentin dhe, nëse është rasti, identiteti i vulës apo pullës që ai mban, formaliteti i vetëm që mund të kërkohej është paraqitja e një vërtetimi, të përshkruar në nenin 4, i lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit që nxjerr dokumentin.

Megjithatë, formaliteti i përmendur në paragrafin e mësipërm nuk mund të kërkohej në rastin kur ligjet, rregulloret ose praktika në fuqi në shtetin në të cilin lëshohet dokumenti ose një marrëveshje midis dy apo më shumë shteteve kontraktuese e ka shmangur ose thjeshtuar atë, apo e përjashton dokumentin nga legalizimi.

Neni 4

Vërtetimi i referuar në nenin 3, paragrafi i parë, do të vendoset në vetë dokumentin ose në një qoshe të dokumentit; ai do të jetë në formën e modelit bashkëngjitur kësaj Konvente.

Megjithatë, ai mund të hartohet në gjuhën zyrtare të autoritetit që e lëshon atë. Termat standarde që shfaqen në të mund të jenë, gjithashtu, në një gjuhë të dytë. Titulli “Apostille”, do të jenë në gjuhën frënge “Apostille” (Konventa e Hagës, 5 tetor 1961).

Neni 5

Vërtetimi do të lëshohet me kërkesë të personit që ka nënshkruar dokumentin ose të çdo mbajtësi tjetër.

Nëse plotësohet rregullisht, ai do të vërtetojë autenticitetin e nënshkrimit, cilësinë në të cilën ka vepruar personi që e ka nënshkruar dhe, nëse është rasti, identitetin e vulës ose pullës që mban dokumenti.

Nënshkrimi, vula dhe pulla në vërtetim përjashtohen nga çdo lloj vërtetimi i mëtejshëm.

Neni 6

Mbështetur në paragrafin e parë të nenit 3, çdo shtet kontraktues do të përcaktojë, duke iu referuar funksionit të tyre zyrtar, autoritetet kompetente për lëshimin e vërtetimit të referuar në paragrafin e parë të nenit 3.

Në momentin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të aderimit ose të deklaratës së zgjerimit, shteti palë njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Hollandës për caktimin e autoritetit kompetent për lëshimin e vërtetimit, si edhe për ndryshimet e mundshme të autoritetit kompetent në të ardhmen.

Neni 7

Çdo autoritet kompetent i përcaktuar në përputhje me nenin 6, do të mbajë një regjistër ose një dokument indeksi në të cilin ai do të regjistrojë vërtetimet e lëshuara, duke specifikuar:

a. numrin dhe datën e vërtetimit;

b. emrin e personit që nënshkruan dokumentin publik dhe cilësinë në të cilën ai ka vepruar ose, në rastin e dokumenteve të panënshkruara, emrin e autoritetit që ka vënë vulën ose pullën.

Me kërkesë të personit të interesuar, autoriteti që ka lëshuar vërtetimin do të vërtetojë nëse të dhënat në vërtetim korrespondojnë me të dhënat e mbajtura në regjistër ose në dokumentin e indeksit.

Neni 8

Nëse midis dy ose më shumë shteteve kontraktuese është lidhur një marrëveshje, traktat ose konventë, që përmban dispozita që ia nënshtrojnë vërtetimin e nënshkrimit, vulës ose pullës disa formaliteteve të

caktuara, kjo Konvente kanë përparësi në lidhje me këto dispozita nëse këto dispozita janë më rigorozë sesa formaliteti i referuar në nenet 3 dhe 4.

Neni 9

Çdo shtet kontraktues do marrë masat e nevojshme për të parandaluar legalizimet nga agjentët e tij diplomatikë dhe konsullorë në rastet kur kjo Konventë parashikon përjashtimin.

Neni 10

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për shtetet e përfaqësuara në sesionin e nëntë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe për Islandën, Irlandën, Lihtenshteinin dhe Turqinë.

Ajo do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Hollandës.

Neni 11

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit të referuar në paragrafin e dytë të nenit 10.

Konventa do të hyjë në fuqi për çdo shtet nënshkrues që e ratifikon në një datë të mëvonshme, në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit.

Neni 12

Çdo shtet, që nuk përmendet në nenin 10, mund të aderojë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të saj në përputhje me nenin 11 paragrafi i parë. Instrumenti i aderimit do të depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Hollandës.

Ky aderim do të ketë fuqi vetëm në lidhje me marrëdhëniet midis shtetit aderues dhe atyre shteteve kontraktuese, të cilët nuk kanë paraqitur kundërshtim për këtë aderim brenda gjashtë muajve nga marrja e lajmërimit, parashikuar nga neni 15, pika *d*. Për çdo kundërshtim duhet të njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës.

Konventa do të hyjë në fuqi, ndërmjet shtetit aderues dhe shteteve, të cilat nuk kanë paraqitur kundërshtime për këtë aderim në ditën e gjashtëdhjetë pas përfundimit të periudhës gjashtë mujore të përmendur në paragrafin më sipër.

Neni 13

Në momentin e nënshkrimit, ratifikimit dhe aderimit, çdo shtet deklaron shtrirjen e efekteve të kësaj Konvente, në të gjithë territorin që ai përfaqëson në nivel ndërkombëtar apo në një ose disa prej tyre. Kjo deklaratë bëhet efektive në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës në shtetin përkatës.

Në çdo kohë më vonë, për çdo shtrirje të kësaj natyre njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës.

Nëse deklarata e shtrirjes bëhet nga një shtet, i cili e ka nënshkruar dhe e ka ratifikuar Konventën, kjo Konventë hyn në fuqi për territoret në fjalë në përputhje me dispozitat e nenit 11. Nëse deklarata e shtrirjes është bërë nga një shtet, i cili ka aderuar, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për këto territore në përputhje me nenin 12.

Neni 14

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi për pesë vjet nga dita e hyrjes së saj në fuqi, në përputhje me nenin 11, paragrafi i parë, edhe për shtetet që e kanë ratifikuar ose kanë aderuar në një datë të mëvonshme.

Nëse nuk ka denoncime, Konventa do të rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.

Çdo denoncim do t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Hollandës të paktën gjashtë muaj përpara përfundimit të periudhës prej pesë vjetësh.

Ajo mund të kufizohet për disa territore në të cilat zbatohet Konventa.

Denoncimi do të ketë efekt vetëm për shtetin që e ka njoftuar atë. Konventa do të mbetet në fuqi për shtetet e tjera kontraktuese.

Neni 15

Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës do të njoftojë shtetet e përmendura në nenin 10, si dhe shtetet që kanë aderuar në përputhje me nenin 12, për sa më poshtë:

- a. njoftimet e referuara në nenin 6 paragrafi i dytë;
- b. nënshkrimet dhe ratifikimet e referuara në nenin 10;
- c. datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 11 paragrafi i parë;
- d. aderimet dhe kundërshtimet e parashikuara në nenin 12 dhe datën në të cilën ato bëhen efektive;
- e. shtrirjet e parashikuara në nenin 13 dhe datën në të cilat ato bëhen efektive;
- f. denoncimet e referuara në nenin 14 paragrafi i tretë.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Hagë, më 5 tetor 1961, në anglisht dhe frëngjisht, ku teksti frëngjisht ka përparësi në rast divergjencash ndërmjet dy teksteve. Kopja e vetme do të depozitohet në arkivat e Qeverisë së Hollandës, dhe prej së cilës, një kopje e vërtetuar do t'i i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në sesionin e nëntë të konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe Islandës, Irlandës, Lihtenshteinit dhe Turqisë.

SHTOJCË E KONVENTËS

Model i vërtetimit

Vërtetimi do të jetë në formën e një katrori me brinjë jo më të vogla se 9 cm.

APOSTILLE

Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961

1. Vendi.....

Ky dokument zyrtar

2. Është nënshkruar nga.....

3. I cili vepron në cilësinë e.....

4. Dhe mban vulën/pullën e.....

Vërtetuar

5. Në.....

6. Më.....

7. Nga.....

8. Nr.....

9. Vula/pulla

10. Nënshkrimi

.....

.....